



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. 01/01-2738 /2021
Dt. 28.01.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 Nr.011-10 të datës 26.12.2008, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.01.2021, pas diskutimeve lidhur më pikën e 5-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozimit të komisionit për përkrahjen e të prekurve nga Covid 19 në Komunën e Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Të sigurohen mjetet financiare dhe të zhvillohen procedurat e rregullta ligjore për sigurimin e barnave dhe shërbimeve mjekësore për të prekurit me Covid 19 në Komunën e Gjakovës si në vijim:
 - 1. Të vazhdohet me sigurimin e testeve Serologjike dhe të njëjtat të bëhen vetëm me rekomandim të mjekut;
 - 2. Të sigurohen reagensë për analizat e D-dimer;
 - 3. Të sigurohen barnat nga Lista e barnave esenciale;
 - 4. Të sigurohen ampulla Fraksiparinë (Fraxiparine).
2. Me barnat dhe analizat e shënuara në pikën 1 të këtij vendimi të furnizohet Barnatorja dhe Laboratori i QKMF-së dhe të njëjtat të shfrytëzohen për të gjithë të prekurit nga Covid-19 në Komunën e Gjakovës me rekomandim dhe recetë të mjekut .
3. Me Fraksiparinë (Fraxiparine) amp. dhe me reagensë për analizë të D-dimer, të furnizohen edhe pacientët nga Komuna e Gjakovës që janë në hospitalizim në Spitalin Regjional "Isa Grezda" në Gjakovë .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale
 - Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa .
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,

Z. Anton Shala